



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.5755/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Ballkan Petrol” sh.p.k Zona Industriale Gërllice Ferizaj, me numër të biznesit .., të cilin e përfaqëson B.A., kundër debitorës Trepça sh.a., me seli në Mitrovicë, rr. “...” pn., me numër të biznesit ..., lidhur me çështjen përmbartimore për pagesën e borxhit duke vendosur sipas ankesës së debitorës, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- PPP.nr.1151//2021, datë 04.07.2022, me datë 15.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike përmbartimore.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Dhomës së Shkallës së Dytë, si gjykatë kompetente në pikëpamje lëndore.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar PPP.nr.1151/2021, të datës 04.07.2022, ka vendosur si në vijim: Refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit TREPÇA sh.a., me seli në Mitrovicë, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.601/2021 i dt. 03.11.2021, sipas propozimit të kreditorit Ballkan Petrol” sh.p.k Zona Industriale Gërllice Ferizaj, me numër të biznesit 810080036, të cilin e përfaqëson B.A.

Kundër këtij aktvendimi, debitorja brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e debitores si e bazuar dhe të anulohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit me referim në ankesën e parashtruar dhe në shkresat e lëndës, konstaton se palët në këtë procedurë përmbarimore - kreditori dhe debitori janë shoqëri tregtare, përkatësisht kreditori sh.p.k (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), ndërsa debitorja sh.a (shoqëri aksionare). Në këtë kuptim dhe me referim në dispozitën e nenit 13 paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatën Komerciale ku përcaktohet se “1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”, 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate” dhe paragrafi 2 të po të njëjtit ligj i cili përcakton se “2. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike,” kështu, nga kjo bazë ligjore dhe në ndërlidhje me rrethanat e rastit, vjen në përfundim se për vendosje në këtë çështje juridike përmbarimore kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë.

Prandaj, mbi bazën e arsyeve si më lart, lënda bashkë me të gjitha shkresat e saj i dërgohet në kompetencë të mëtejme Gjykatës Komerciale për të vendosur sipas ankesës së debitores “Trepça” sh.a, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.1151/2022, datë 04.07.2022.

Nga të lartcekurat e në bazë të dispozitës së nenit 10, 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 29 dhe 208 të LPK-së dhe nenin 77 dhe 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 5755/2022, me datë 15.04.2024

Gjyqtarja
Hunaida Pasuli